

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha me pjesëmarrjen e sekretares juridike Teuta Spahiu procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit Sh. E. nga fshati M. Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.2879/2015 të datës 10.12.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në praninë e prokurorit të shtetit në Prizren Musli Gashi dhe të akuzuarit, me datë 02.11.2017 publikisht morri dhe shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

#### I akuzuari:

**SH. E.** nga i ati E. dhe e ëma Sh. e lindur K., i lindur më datë *data e lindjes...* në fshatin M. Komuna e Prizrenit ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën fillore, kopshtar, i martuar, me numër personal *numri personal...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

### ËSHTË FAJTOR

Me datë 27.05.2015, në fshatin M. Komuna e Prizrenit në shtëpinë e tij familjare, me qëllim që ti sjell vetit pasuri të kundërligjshme si shfrytëzues i shërbimeve komunale, përfiton nga shërbimi komunal që furnizohet përmes rrjetit përçues dhe shpërndarjes së energjisë elektrike pa autorizim të furnizuesit të autorizuar, shfrytëzon energjinë elektrike me njehsor numër 17735186 të cilit i mungojnë pllombat shtetërore, rreth qelqit nga ana e djathtë është futur shiriti filmit, në brendi njehsori ka pluhur të shiritit dhe në këtë mënyrë është penguar puna e diskut, ashtu që energjia e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç'rast ndërmarjes së dëmtuar KEDS – Distribucioni në Prizren ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 690.49 €.

#### **Kësodore ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK.**

Gjykata në bazë të nenit 7, 41, 49, 50, 51, 73 dhe nenit 320 të KPK i shqipton dënimin dhe atë:

### DËNIM ME KUSHT

Ashtu që vërteton

- dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

- dënimin me gjobë në lartësi prej 150 € (njëqind e pesëdhjetë euro) i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

I akuzuari obligohet të dëmtuarës KEDS – Distribucioni në Prizren, në emër të dëmit të shkaktuar të paguaj shumën në lartësi prej 690.49 €, pesëmbëdhjetë ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

I akuzuari obligohet të paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 €, në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Mbikqyerjen e dënimit me kusht do të bëjë Shërbimi Sprovues në Prizren në pajtim me nenin 159 par.1 të LESP.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.2879/2015 të datës 10.12.2015, kundër të akuzuarit Sh. E. nga fshati M. Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK.

Gjykata në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit, i shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarit. I akuzuari pas kësaj deklaroi se ka kuptuar aktakuzën dhe nuk e kundërshton provat materiale.

Gjykata në seancën fillestare ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ditën kritike në datë 27.05.2015, në shtëpinë e tij familjare e cila gjendet në fshatin M. Komuna e Prizrenit, i akuzuari Sh. E. me shifër të konsumatorit 39265 me numër të njehsorit elektrik 17735186, pas një kontrolli nga ana e zyrtarëve të KEDS – Distribucioni në Prizren, është vërtetuar se i akuzuari përfiton nga shërbimi komunal që furnizohet përmes rrjetit përçues dhe shpërndarjes së energjisë elektrike pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, e shfrytëzon energjinë elektrike me njehsor të cilit i mungojnë pllombat shtetërore, rreth qelqit nga ana e djathtë është futur shiriti filmit, në brendi njehsori ka pluhur të shiritit dhe në këtë mënyrë është penguar puna e diskut, ashtu që energjia e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç'rast ndërmarjes së dëmtuar KEDS – Distribucioni në Prizren ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 690.49 €.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike ka vërtetuar nga pranimi vullnetar i fajësisë nga ana e akuzuarit për veprimet e përshkruara si në përshkrimin faktik të aktakuzës. . Gjykata nuk gjeti se në shkresat e lëndës ka prova të papranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale me të cilën ngarkohet dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht. Vlen të theksohet se pranimi i fajit është mbështetur në fakte që përmbanë aktakuza, me ç'rast i akuzuari prej fillimit të procedurës ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale, të cilat gjatë shqyrtimit kryesor nuk i ka kundërshtuar. Po ashtu gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarit është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 246 të KPPK dhe në veprimet e tij formohen të gjitha elementet e qenësore të veprës penale e përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marjes së vendimit mbi dënimin gjykata i morri parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, pasi që gjykata nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese, ndërsa si rrethanë lehtësuese morri parasysh faktin se ka pranuar fajësinë dhe ka tregu bashkëpunim me organet e drejtësisë, sjellja korrekte gjatë

zhvillimit të procedurës, pendimi për kryerjen e veprës penale, është i gjendjes së dobët ekonomike dhe mbajtës i familjes, gjer më tani nuk ka kryer vepër penale, andaj bazuar në të gjitha këto gjykata i shqiptoj dënimin si në shqiptim të këtij aktgjykimi, e bindur se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e këtilla, me bindje se është proporcionale me peshën e veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor.

Vendimi mbi kompensimin e dëmit të dëmtuarës, është marë konform nenit 463 par.1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marë në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.2072/2015 të datës 02.11.2017**

**Proçesmbajtësja**  
**Teuta Spahiu**

**Gjyqtarja**  
**Teuta Krusha**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.